



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Kuvendi i Komunës-
01Nr. 16-27322/2012
Kaçanik: 31.10.2012

Në bazë të nenit 11, 12.2(c) , të nenin 34.4 lidhur me 40.2(a) të Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ të MAPL nr. 2008/08, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat , vendbanimet dhe lagjet urbane, si dhe nenit 36.2 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 31.10.2012, merr këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E RREGULLORES 01Nr. 16-27322/2012-PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

I.

APROVOHET Rregullorja **01Nr. 16- 27322/2012**, më tekstin e mëtejme (Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Kaçanikut).

II.

Rregullorja si në pikën I. të këtij Vendimi ka për qëllim të rregulloj organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, në territorin e komunës në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetjake të komunës përcaktuar si në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

III.

Rregullorja e përcaktuar si në pikën I. përmban gjithsej : 17 nene + Lista e Këshillave të qendrës urbane dhe fshatrave, vendbanimeve të komunës, e përfshirë në 2 faqe në shtojcë dhe është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës.

V.

Më këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës(kopja: Zyrtarit Ligjor), Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Xhelal Gashi